



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.479/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, Kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, të paraqitur kundër subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YHTP), me seli në Prizren, gjegjësisht kundër kandidates për deputete nga ky subjekt politik Sevil Liman Kazaz, për shkak të ndikimit tek votuesit gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.479/2025 e datës; 09.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, kundër subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YHTP), me seli në Prizren, gjegjësisht kundër kandidates për deputete nga ky subjekt politik Sevil Liman Kazaz, për shkak të ndikimit tek votuesit gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 09.02.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Yenilikçi Turk Hareket Partisi (YHTP), me seli në Prizren, gjegjësisht kundër kandidates për deputete nga ky subjekt politik Sevil Liman Kazaz me te cilën pretendohet se në shkollat Mati Logoreci (2010-Prizren), Motrat Qiriazi (2003-Prizren) dhe 11 Marsi (2011-Prizren) te cilat shërbejnë si qendra te votimeve qëndronte pranë hyrjes se qendrës se votimit dhe ndër vepronte me votuesit në një mënyrë që mund te interpretohet si përpjekje per te ndikuar ne vendimin e tyre. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZA-i që të ndermirren veprimet e nevojshme ligjore. Si provë në ankesë ka bashkangjitur fotot.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datën 10.02.2025, nga Sevil Kazazi thekson se ky konstatim apo interpretim nuk është i vërtetë, pasi që unë kam qenë duke shkuar për të votuar në shkollë dhe gjatë asaj kohe rastësisht jam takuar me një familjare jashtë hyrjes së shkollës,

si dhe jemi përshëndetur dhe kam vazhduar në vendvotim. Ky rast i cili është fotografuar nuk ka të bëjë me ndonjë dyshim për të ndikuar në vullnetin e votuesve, pasi që edhe nuk është përcekur në ankesë se në cilën shkollë është fotografuar rasti. Ndërsa për interpretimet tjera që unë kam qenë në disa shkolla, asnjëri nuk është i vërtetë pasi që edhe ankuesja nuk ka provë tjetër për të dëshmuar pretendimin. Andaj kërkoj nga PZAP-i që të hudh ankesën si e pa bazuar pasi që ankuesja nuk ka prova të bazuara për të vërtetuar pretendimet e saj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik KDTP me te cilën pretendon se kandidatja për deputete nga subjekti politik YHTP Sevil Kazazi ka ndikuar tek votuesit për të votuar, paneli vlerësoi se janë të paqëndrueshme sepse nuk ka asnjë provë të bazuar lidhur me këto pretendime. Ne foton e bashkangjitur si prove ne ankesë shihet vetëm një fotografi me një person duke qëndruar para hyrjes së një objekti, ndërsa ne ankese pretendon se ka bere përpjekje për te ndikuar ne disa shkolla te cilat kane shërbyer si qendra te votimeve.

Andaj nga këto shkresa të lëndës paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë ndikuar tek votuesit, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe hetuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të padyshimtë, se pretendimet ankimore janë të pabazuar në ligj sepse të njëjtat, nuk mbështeten me asnjë provë nga parashtruesi i ankesës, andaj ankesa u refuzua e pabazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.479/2025 datë; 11.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.